



Rr. Hamdi Mramori Nr. 1  
Prishtinë 10000 – Kosovë  
Tel: +381 (0) 38 247 615 ext. 103  
Fax: +381 (0) 38 247 620  
e-mail: info@ero-ks.org  
www.ero-ks.org

**ANEKS**

**RAPORTI RREGULLATIV**  
**Përcaktimi i Tarifave për Ngrohtoren e Qytetit GJAKOVË SH.A.**  
**Sezoni i Ngrohjes 2007-2008**

**Prishtinë, 12 Nëntor 2007**

## **PËRMBLEDHJE**

Duke ju referuar faqes 24 të ANEKS-it të Vendimit të ZRrE-së D\_71\_2007 – RAPORTI RREGULLATIV “Përcaktimi i të Ardhurave të Lejuara për Ngrohoren e Qytetit GJAKOVË SH.A. për Sezonin e Ngrohjes 2007 - 2008”; mbledhjes së Bordit të ZRrE-së të mbajtur me 01 nëntor 2007 dhe pastaj aprovimin unanimit nga Bordi i ZRrE-së i të Ardhurave të Lejuara; dhe vendimin e ZRrE-së: D\_71\_2007 të 01 nëntorit 2007, **të Ardhurat e Lejuara për NQ GJAKOVË janë definuar në vlerën €883,044, nga e cila Pjesa Fikse është €172,141 dhe Pjesa Variabile është €710,903.**

Për përcaktimin e tarifave për NQ GJAKOVË-n për sezonin e ngrohjes 2007-2008, ZRrE i referohet Aneksit 2 të Udhëzimit të Përkohshëm I\_05\_2007 mbi “Parimet e Llogaritjes së Tarifave dhe Çmimeve në Sektorin e Ngrohjes Qendrore për Sezonin e Ngrohjes 2007-2008”. Të gjitha formulat e shpjeguara në Aneksin 2 të Udhëzimit I\_05\_2007 janë llogaritur për NQ GJAKOVË që për bazë kanë të Ardhurat e Lejuara të aprovuara për sezonin e ngrohjes 2007-2008 siç është cekur më lartë, në vlerë prej **€883,044.**

Në propozimin e tarifave – detajet për llogaritjen e tarifave, dorëzuar nga NQ GJAKOVA me 5 nëntor 2007, është vërejtur një ndryshim i vogël në llogaritjen e tarifave që nuk përputhet me llogaritjen e ZRrE-së. Më saktësisht, kontrollimi nga ZRrE-ja i llogaritjes së tarifave tregon se ky ndryshim rezulton nga pika A.2; ku NQ Gjakova ka adoptuar 1,200 orë në vend se 1,300 orë për Orët e Ngarkesës së Plotë (LHi) gjatë llogaritjes së Kërkesës për Ngrohjes (HDi) për grupin e konsumatorëve komercial e institucional. Si pasojë e kësaj, rezultati final i llogaritjes së tarifave të NQ Gjakovës nga ZRRE-ja ndryshon nga propozimi i NQ Gjakova siç është dhënë në tabelë.

Më tutje, në propozimin e tarifave, NQ GJAKOVA propozon të zbriten 12 €cent nga tarifa e konsumatorëve të amvisërisë, dhe në të njëjtën kohë të rritet për 19 €cent tarifa për konsumatorët Komercial e Institucional. Arsyeja për këtë është të merret parasysh gjendja e rendë ekonomike e konsumatorëve të amvisërive dhe kjo të kompensohet me një rritje të vogël të tarifës së konsumatorëve Komercial e Institucional.

ZRrE-ja i pranon arsyet e cekura me vërejtjen se vlerat e propozuara për tu zbritur / shtuar për grupet respektive të konsumatorëve (amvisërisë dhe komercial/institucional) nuk janë në proporcion të saktë me sipërfaqet ngrohëse të tyre, kërkesën për ngrohje dhe me të Ardhurat e Lejuara të tyre.

Prandaj, ZRrE-ja i ka përshtatur tarifën në përputhje me proporcionin e saktë të sipërfaqeve ngrohëse, kërkesës për ngrohje dhe me të Ardhurat e Lejuara për grupet respektive të konsumatorëve, duke zbritur 8 €cent nga komponenta variabile e tarifës së konsumatorëve të amvisërisë dhe ka shtuar 12 €cent në komponentin variabile të tarifës së konsumatorëve komercial e institucional, e cila përshtatje është përfshirë në komponentin variabilë të tarifës pas përshtatjes.

**PERCAKTIMI I TARIFAVE PER NQ GJAKOVE SH.A. - SEZONI 2007/2008**

Formulat sipas Udhëzimit të Përkohshëm I_05_2007 - Aneksi 2	Përshkrimi	Njësija	Konsumat. Amvisrisë	Konsumat. Komerical& Institucion.	Totali konsumator.
Rf	Pjesa Fikse e të Ardhurave të Lejuara	€	74,703	97,438	172,141
Rv	Pjesa Variabile e të Ardhurave të Lejuara	€	308,505	402,398	710,903
<b>R</b>	<b>Totali i të Ardhurave të Lejuara</b>	<b>€</b>	<b>383,208</b>	<b>499,836</b>	<b>883,044</b>

**A. TARIFA PER KONSUMATORET E PAMATUR**

A.2	$HD_i = (CD_{spi} \times Si \times LHi) : 10$	Kërkesa specifike për kapacitet e një grupi të veçantë konsum.	w/m2	100	120	$HD_r = \sum_{i=1}^n HD_i$	
	$CD_{spi}$ $Si$	Totali i sipërfaqes ngrohëse l një grupi të veçantë konsum.	m2	69,000	75,000		144,000
	$LHi$ $HD_i$ $i$ $HD_r$	Orët nominale të ngarkesës së plotë të një gr. të veq. Kons. Kërkesa sezonale për ngrohje e një gr. të veq. të konsum. Grupi i konsumatorëve Kërkesa totale për ngrohje e tërë konsumatorve	h MWh	1,300 8,970	1,300 11,700		20,670
A.4	$HD_k = HD_i : HD_r$	Raporti i kërkesës për ngrohje për çdo grup konsumat	€	43.40%	56.60%		
A.5	$RI = R \times HD_k$	Të ardhurat e lejuara për një grup të veçant konsumator	€	383,208	499,836	883,044	
A.6	$R_{if} = R_f \times HD_k$	Të ardhurat e lejuara fikse për një grup të veçant konsum	€	74,703	97,438	172,141	
	$R_{iv} = R_v \times HD_k$	Të ardhurat e lejuara variabile për një grup të veçant konsum.	€	308,505	402,398	710,903	
A.8	$Ty_{hc} = R_{if} : Si$	Tarifa për sezonë e kapacitetit të kontraktuar të ngrohjes (komponenta fikse) për grupin e veçant të konsumatorëve	€/m <sup>2</sup>	1.08	1.30		
A.9	$Ty_{hd} = R_{iv} : Si$	Tarifa për sezonë e ngrohjes së furnizuar (komponenta variabile) për grupin e veçant të konsumatorëve	€/m <sup>2</sup>	4.47	5.37		
A.10							
a)	$Tm_{hc} = Ty_{hc} : 6$	Tarifa mujore e kapacitetit të kontraktuar të ngrohjes (komponenta fikse) për grupin e veçant të konsumatorëve	€/m <sup>2</sup>	<b>0.18</b>	<b>0.22</b>		
b)	$Tm_{hd} = Ty_{hd} : 6$	Tarifa mujore e ngrohjes së furnizuar (komponenta variabile) për grupin e veçant të konsumatorëve	€/m <sup>2</sup>	<b>0.75</b>	<b>0.89</b>		
		Tarifa mujore e ngrohjes së furnizuar (komponenta variabile) për grupin e veçant të konsumatorëve pas p në vijim të propozimit nga NQ Gjakova të dt. 5 nëntor 2007	€/m <sup>2</sup>	<b>0.67</b>	<b>1.01</b>		

**B. TARIFA PËR KONSUMATORET E MATUR**

B.2	<b>N</b>	Kapaciteti total i kontraktuar i ngrohjes	kW			15,900
B.3	<b>Q</b>	Ngrohja e furnizuar (dërguar) konsumat. gjatë tërë sezonit	MWh			15,497
B.2	$Ty_{hc} = R_f : N$	Tarifa sezonale e kapac. të kontrakt. të ngroh. (komp. fikse)	€/kW			10.83
B.4	$Tm_{hc} = Ty_{hc} : 6$	Tarifa mujore e kapac. të kontrakt. të ngroh. (komp. fikse)	€/kW			<b>1.80</b>
B.3	$Ty_{hd} = R_v : Q$	Tarifa e ngroh. së furniz. (dërguar) konsumat. (komp. variab	€/MWh			<b>45.89</b>

\* Të gjitha shkurtesat gjenden në Udhëzimin e Përkohshëm I\_05\_07.